

K O N T R A T E

E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "RROKU" SH.P.K.

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA

Ne baze te ligjit 7512 Dt 10.8.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarive private te pavarura dhe privatizimin", ligjit 7638 Dt 19.11.1992 " Per shoqerite Tregetare" dhe ligjit 7667 Dt 28.1.1993 per rregjistrin tregetar", me vullnetin e tyre te lire, te shprehur dhe ne nenshkrimin e kesaj kontrate:

Ortaku i vetem

Z. Viktor Rrok **Caushi** i dt 1963 banues ne lagjen "Daniel Matlia" Rr "Rasim Berdica" Nr-777 Shkoder.

Ka krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me emer-in-shoqeri me pergjegjesi te kufizuar "RROKU" SH.P.K.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Rroku" Sh.p.k. ka per objekt te veprimtarise ekonomike:

- Ndermarje ndertimi-restaurime, punime dheu, ndertime banesash civile, rruga, ura, ujesjellsa, linja tensioni te nalte, linja telefonike dhe objekte te industriale etj.

SELIA E SHOQERISE

Sela e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Rroku" Sh.p.k. eshte ne lagjen "Daniel Matlia" Rr "Rasim Berdica" Nr 777-Shkoder.

KOHEZGJATJA

Jetegjatesi e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Rroku" Sh.p.k. eshte mbi 11 vjete.

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Rroku" Sh.p.k.; ka llogarine rjedhese ne banke ne Nr _____, me kapital themeltar 100.000 leke. i cili eshte i pandare dhe pjese e ortakut te vetem ne masen 100%



Asambleja e ortakëve është organi më i lartë i shoqërisë, por në rastin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Arku" Sh.p.k. përfaqësohet nga ortakët e vetëm.

Administratori i shoqërisë është Viktor Caushi.

Vendimet e ortakut të vetëm dhe administratorit të shoqërisë, janë të detyrueshme për shoqërinë dhe bëjnë pasojë për të tretë.

Kundër vendimeve të ortakut të vetëm dhe administratorit të shoqërisë të tretët, mund të ankohen në gjykatën e rrethit të Tiranës, ku janë të depozituara dhe dokumentat e kësaj shoqërie.


Kundër vendimeve të kësaj gjykate, ankimi, do të ndjekë rrugën ligjore ankimore.

Mardhëniet e punës në shoqëri do të rregullohen me kontratën e punës, për çështje që nuk rregullohen me kontratë pune, do të zbatohen dispozitat e legjislativës të punës të Republikës së Shqipërisë. Kjo është e njëjtë dhe për agjensitë, zyrat e përfaqësimit dhe filialet.

Kontratat firmohen rregullisht nga ortakët e vetëm dhe administratori i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Rroku" Sh.p.k.

Ortakët e vetëm

Viktor Caushi



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

NOTERIA - SHKODER


Nr. Repertori 5790

Nr. Koleksionit 7378

AUTENTIFIKIM - NENSHKRIMI

Sot në datën 28.5.1994 u paraqitë në zyrën e Notarisë Shkoder, qytetari Viktor Rrok Caushi i dt 1963 banues në lagjen "Daniel Matlia" Rr "Rsim Berdica" Nr 777 Shkoder, i identifikuar, me aftësi për të vepruar, të cilit i vertetova autentifikimin e nëshkrimit të dokumentave.

Notere
Violeta Voin Sulkaj



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "RROKU" SH.P.K.

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, KOHEZGJATJA, SELIA E SHOQERISE;

KREU I

EMERTIMI

Neni 1

Ne baze te ligjit 7512 Dt 10.8.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarive private te pavarura dhe privatizimin", ligjit 7638 Dt 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare" dhe ligji 7667 Dt 28.1.1993 " Per rregjistrin tregetare", me vullnetin t tije te lir te shorehur dhe me nenshkrimin e kontrates, bashkalidhur ketije statuti, ortaku i vetem:

Z. Viktor Rrok Caushi i dt 1963 banues ne lagjen "Daniel Matlia" Rr "Tasim Berdica" Nr 777 Shkoder.

Ka krijuar nje shoqeri mepergjegjesi te kufizuar, me emer "Rroku" Sh.p.k.

Neni 2

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Rroku" Sh.p.k. e fiton personalitetin Juridik, me rregjistrimin ne gjykaten e rrethit Tirane. Ajo eshte perso Juridik privat Shqiptar dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me kerkesat e ligjislacionit Shqiptar, ne fuqi, dhe te akteve te saj themeluese.

Kreu II

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Rroku" Sh.p.k. eshte:

Ndermarje ndertimesh, restarurimesh, ndetime banesa civile, punime dheu, rruga, ura, ujeshjellsa, linja tensioni te nalte, linja telefonike, objekte industriale etj.

Veprimtaria e mesiper ka per qellim qe te arihen objektivat e lartepermendura, ne perputhje dhe duke respektuar programet e veprimtarise ekonomike-finaciare, te parashtruara dhe te miratuara nga ortaku i vetem.

Kreu III

SELIA E SHOQERISE

Neni 4

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Rroku" Sh.p.k. eshte: ne lagjen "Daniel Matlia" Rr "Tasim Berdica" Nr 777 Shkoder.

Aktiviteti i shoqerise shtrihet ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. qendra e ortakut te vetem eshte e shenuar ne Dibrin e shoqerise. Ajo munde e hape zyra perfaqesimi, filiale dhe agjensi apo qendra dytesore, mbeshtetur ne krateret e miratuara nga organet perkatese, si dhe legjislacionin e vendit ku ato krijohen.

KOHEZGJATJA

Neni 5

Vetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Rroku" Sh.p.k; eshte mbi 11 vjete. Ajo munde te shperndahet dhe perpara ketije afata, me vendim te ortakut te vetem, kur verifikohen rrethana qe e bejne te pamundur vazhdimin e veprimtarise si dhe ne raste se shpendanja e saj urdherohet ne meny te prere nga ligji.

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar "Rroku" Sh.p.k. është _____, i dërdhur në bankën Shkoder, në llogarinë rrethuese Nr. _____. Është pjesë, tërësisht, e ortakut të vetëm-100%.

Ndryshimi i masës së kapitalit themeltar, shtimi apo pakesimi i tij, het me vendim të ortakut të vetëm.

Neni 7

Kuotat ose pjesët janë nonimative dhe lirisht të transferueshme nga ortakut i vetëm tek të tretët.

Transferimi i tyre bëhet vetëm me akt Noterial.

Neni 8

Kuotat e pjesëmarrjes në kapital janë të gjitha të emërtuara dhe të pandashme. Çdo kuotë i takon e drejta e një vote.

KREU IV

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 9

Asambleja e ortakeve është organi më i lartë i shoqërise, në rastin e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar "Rroku" Sh.p.k. përfagesohet nga ortakut i vetëm.

Vendimet e tij në përputhje me ligjen dhe aktet themeluese të shoqërise janë të detyrueshme, por të tretët kanë të drejtën e ankimit kundër këtyre vendimeve, kur e çmojnë se janë prekur interesat e tyre.

Neni 10

Organi vendimor i shoqërise është asambleja e ortakeve, por në rastin e kësaj shoqërie është ortakut i vetëm, i cili njëherësh është dhe administratori i shoqërise. Ky i fundit ka të drejtë të vendosë për-emërtimin e ekspertëve kontabel dhe likuidatoreve e për shkarkimin e tyre, miratimin e raportit të administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore dhe fitimit. Gjithashtu ka të drejtë të vendosë dhe për-ndryshimet në statut, zvogëlimin e kapitalit tek të tretët, zgjatjen e kohës së veprimtarisë së shoqërise apo shpërndarjen e sajë etj.

Neni 11

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Rroku" Sh.p.k. vepron në rregjimin e pronës private dhe mer persipër vetë të drejta dhe detyrime. Ajo përgjigjet për detyrimet e veta kontraktore dhe jashtëkontraktore, branda kapitalit të sajë.

Ortakut i vetëm mbartë rrezikun për veprimtarinë e shoqërise, në nivelin e pasurive të shoqërise.

Neni 12

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Rroku" Sh.p.k. drejtohet nga një administrator, që është ortakut i vetëm-Viktor Caushi. Ai ka të drejtë të kryejë të gjitha aktet që i konsideron të nevojshme për aritjen e qëllimeve të shoqërise. Ai ka të drejtë, ndërmjet të tjerash, të blejë ose të kembejë pasuri, të lidhet me shoqëri të tjera, të krijuara apo që do të krijohen, brenda vendit apo dhe jashtë tij, duke siguruar pjesëmarrje për qëllimet e veprimtarisë ekonomike.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërise dhe të treteve, qoftë për shkeljet e tij ligjore, të statutit, ose dhe për fajet të kryera gjatë administrimit.

Neni 13

Në rast të nevojës, ose kur kërkohet ligja, kontrolli i shoqërise kryhet nga një ekspert kontabel, i cili emërohet nga administratori i shoqërise.

[Signature]

ste se verëhen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyrës prej tij, ai shkarkohet) në të njëjtën mënyrë si dhe është emëruar.

Neni 14

Te gjithë të punësuarit në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "Rroku" Sh.p.k. kanë detyrimin të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë, duke e vërejtur këtë të drejtë dhe pas largimit nga shoqëria.

Neni 15

Kreu V

SHPËRBERJA E SHOQËRISE

Shpërberja e shoqërisë mundet të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo lloje shkak. Si për humbje të kapitalit të shoqërisë, pamundësi të veprimtarisë së shoqërisë - me vendim të ortakut të vetëm, si dhe kur shpërberja e sajë urdhet në mënyrë të prerë nga ligji. Në këto raste - ortakut i vetëm vendos për mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose disa likuidatore, duke përcaktuar detyrat. Këto kujdesin në radhë të parë që të shpëtojë detyrimet ndaj të tjerëve.

Neni 16

Përse nuk shprehet plotësisht në këtë statut, do të referohet plotësisht në veqe mundet të bëjë ortakut i vetëm si dhe ligjeve të veçanta të legjislativës së Shqipërisë.

Neni 17

Te gjitha kundërshtimet e të tjerëve ndaj shoqërisë, pra mosmarveshjet dhe zgjidhet nga gjykata e rrethit të Tiranës, ku janë të depozituara dhe dokumentacioni i kësaj shoqërie.

Neni 18

Kundër vendimeve të kësaj gjykate, palet mundet të ankohen. Ankimi do të ndjekë rrugën ligjore për ankimet.

Neni 19

Mardheniet e punës në shoqëri do të rregullohen me kontratë pune, çështjet që nuk rregullohen me kontratë pune, do të zgjidhen duke ju referuar legjislativës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 20

Ky statut firmoset rregullisht prej ortakut të vetëm dhe administratorit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Rroku" Sh.p.k.

Ortakut i Vetëm

Viktor Caushi



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

NOTERIA - SHKODER

Nr. Repertori

5780

Nr. Koleksioni

2379

AUTENTIFIKIM - NENSHKRIMI

Sot në datën 28.5.1994 u paraqitë në zyrën e Noterisë Shkoder, personat e caktuar - Viktor Rrok Caushi i dt 1963 banues në lagjen "Daniel Matia", "Rr" Tasim Berdica" Nr 777 - Shkoder, i identifikuar, të cilët i vertetova autentifikimin e nënshkrimit, të dokumentit.

Noterë
Violante Voin Shkaj

